



# **SRPSKA LISTA (SL)**

**Raportet Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur**

**01 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2023**

**Përmbajtja:**

Raport i auditorëve të Pavarur.. .....	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Informata te pergjitheshme .....	9
Shënimet e pasqyrave financiare.....	10-14

# Raport i Auditorëve të pavarur

## Drejtuar Kryesisë së "SRPSKA LISTA"

### Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

#### Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik "SRPSKA LISTA" (në vijim referuar si "Subjekti Politik" apo "SL"), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2023, Pasqyra e te hyrave dhe shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq 10-14.

#### Baza për Opinion te kualifikuar:

- Ashtu siç është shpalosur ne shënimin 2 te Pasqyrave financiare përcjellëse Subjekti Politik Srpska Lista per shpenzimet Reklama, reprezentacioni dhe konferenca ka paraqitur shpenzimet ne shume prej 100.000.00 Euro. Duke pas parasysh natyren e shenimeve qe mban subjekti politik dhe ne mungese te dokumentacionit mbështetës ne e kishim te pamundur te konstatojm se për shpenzimet e paguara a jane pranuar shërbimet dhe a kanë ndërlidhje me aktivitetin politik te Subjektit politik, bazuar në Ligji Nr. 04/L-058/ për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve Politike.
- Ashtu siç është shpalosur ne shënimin 2 te pasqyrave financiare përcjellëse Shpenzimet, subjekti, politik, Srpska Lista ka deklaruar shpenzime të ndryshme ne vlere 14.833.90Euro. Gjate auditimit ton ne kemi konstatuar qe vlera prej 4,789.10 Euro jane shpenzime te papranuara dhe ta pa dokumentuara.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Subjekti politik në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

#### Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar me tej opinionin ton ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik Srpska Lista ka bërë Rideklarimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2023/2022 , rideklarimi ka ardhë si pasoj e mosprezantimit dhe mos rexhistrimit te mjeteve financiare te nje llogarije te dyte ne BKT,
- Subjekti Politik ka Ri-deklaruar pasqyrat financiare të vitit 2022 për të korrigjuar gabimet në formularin e raportimit, në prezantimin në zërat: Paraja dhe ekuivalentët e parasë, Pasurive tjera afatshkurtra dhe Humbjeve/Fitimeve te akumuluar, si pasoj e

mosprezantimit dhe mos rexhistrimit te mjeteve financiare te nje llogarije te dyte ne BKT,

- Subjekti Politik e ka të definuar me statut kontrollin e brendshëm financiar, me statut është parapare qe me një akt te veçantë te Bordit Mbikëqyrës te definohet mbikëqyrja dhe kontrolli financiar, por qe mungon një akt i tillë i veçantë i Organit Mbikëqyrës te SP, i cili do ta definonte qarte Kontrollin e brendshëm financiar për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti politik ka me shume se një llogari aktive bankare vetëm ne një banke komerciale, konfirmimet nga banka komerciale janë se vetëm njëra është llogari kryesore dhe tjerat janë nen-llogari të degëve të SP, por ne kemi vlerësua përsëri se kjo nuk është ne harmoni me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

### **Cështje tjera**

- Pasqyrat financiare të Subjektit Politik për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2022 janë audituar nga auditor tjetër opiniononi i të cilëve mbi këto pasqyra ka qenë i kualifikuar për shpenzimet e Reklamave, reprezentacionit dhe konferencave.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj(parimi i vijimësisë),shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës se kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Subjektit Politik.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi,dhe për të nxjerrë raportin e një audituesit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

## **Audit & Conto sh.p.k**

---

Nijazi Jakupi  
Auditor Ligjor  
21 Qershor 2024

**Pasqyra e Pozitës Financiare**

<b>Pasuritë</b>		<b>Me 31 Dhjetor 2023</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2022</b>
<b>Pasuritë afatgjata</b>	Shënimi	<b>Shuma në Euro</b>	<b>Shuma në Euro (ri deklaruar)</b>
Toka, objektet dhe pajisjet	5	6,351.44	5,700.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>6,351.44</b>	<b>5,700.00</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme	6	132.39	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	260,731.64	244,297.99
Pasuritë tjera afatshkurtra			
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>260,864.03</b>	<b>244,297.99</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>267,215.47</b>	<b>249,997.99</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluar		242,118.07	104,266.25
Suficiti / (deficiti) i vitit		18,430.62	137,851.82
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>260,548.69</b>	<b>242,118.07</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyra		6,351.44	5,700.00
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>6,351.44</b>	<b>5,700.00</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	270.00	269.94
Huatë e pagueshme		0.00	0.00
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	45.34	1,909.98
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>315.34</b>	<b>2,179.92</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>6,666.78</b>	<b>7,879.92</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>267,215.47</b>	<b>249,997.99</b>

**Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2023	2022
			(ri deklaruar)
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga buxheti		311,810.70	350,000.00
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	0.00	0.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4		
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyra	5	2,537.86	1,900.00
Të hyrat tjera			
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>314,348.56</b>	<b>351,900.00</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Pagat dhe kompensimet	2	130,349.21	55,344.08
Shpenzimet e transportit	2	6,143.61	2,205.36
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	101,196.65	103,984.50
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	0.00
Blerja e mallrave	2	0.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	43,394.87	47,942.09
Shpenzimet e ndryshme	2	14,833.90	4,572.15
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>295,917.94</b>	<b>214,048.18</b>
<b>Suficiti / (deficiti) për vitin</b>		<b>18,430.62</b>	<b>137,851.82</b>

## 1. Informata të përgjithshme

Subjekti Politikë: Srpska Lista  
Akronimi: SL  
Selija: Mitrovicë Veri  
Web faqja: <http://www.srpskalista.net/>  
NF: 601543730  
E regjistruar: 12.05.2017 numri regjistruar 209-0517  
Kryetar : Zlatan Elek  
Përf.Financier: Darko Radovanovic

Pasqyrat financiare të Subjektit Politik janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 10 të Ligjit 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058 , Subjekti i regjistruar politik brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e rezultateve preliminare të kontrollimit mund ta dorëzojë raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimin lidhur me çdo gabim të dukshëm ose lëshim të identifikuar nga auditorët. Mosrespektimi i këtij afati nënkupton pajtimin me të gjeturat e auditorit.

Subjekti Politik posedon një llogari aktive në bankat komerciale.



**Shënimi 2. Shpenzimet**

<b>Shpenzimet</b>	<b>Shpenzimi në Euro</b>	<b>Pagesa në Euro</b>	<b>Borxhi i mbetur në Euro</b>
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto	110,418.76	110,418.76	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	6,206.13	6,245.77	(39.64)
Kontributet pensionale të punëdhënësit	6,206.13	6,245.77	(39.64)
Tatimet në të ardhura personale	7,518.19	7,571.30	(53.11)
Beneficionet tjera	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>130,349.21</b>	<b>130,481.60</b>	<b>(132.39)</b>
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara	000	0.00	0.00
Karburantet	1,671.49	1,671.49	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.	3,458.32	3,458.32	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	1,013.50	983.50	30.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	000	0.00	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>6,143.31</b>	<b>6,113.31</b>	<b>30.00</b>
<b>Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			
Lokali	000	0.00	0.00
Ushqimi	996.65	816.65	180.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative	000	0.00	0.00
Radio dhe spotet televizive	000	0.00	0.00
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta	200.00	200.00	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	100,000.00	100,000.00	0.00
<b>Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>101,196.65</b>	<b>101,016.65</b>	<b>180.00</b>
<b>Shpenzimet e fushatës</b>			
Shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e fushatës</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

## SRPSKA LISTA

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor 2023

<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës	0.00	0.00	0.00
Pajisjet të vogla	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Qiraja e lokalit të zyrës	38,901.00	38,901.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	1,956.01	1,956.01	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	2,537.86	////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>43,394.87</b>	<b>40,857.01</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	14,833.90	14,833.90	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>14,833.90</b>	<b>14,833.90</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>295,917.94</b>	<b>293,302.47</b>	<b>77.61</b>

**Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
<b>Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla</b>				//////////	////////	////////

**Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime**

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga				Vlera
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro
					0.00
<b>Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime</b>					<b>0.00</b>

**Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet**

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fund të vitit (vlera neto)
Toka			////////////////////	////////////////////	
Objektet					
Veturat	9,500.00	3,189.30	3,800.00	2,537.86	6,351.44
Pajisjet e zyrës					
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
<b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet</b>	<b>9,500.00</b>	<b>3,189.30</b>	<b>3,800.00</b>	<b>2,537.86</b>	<b>6,351.44</b>

**Shënime tjera**

<b>Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro</b>
..... blerësi 1		
..... blerësi 2		
Llogari të arkëtueshme të tjera	132.39	0.00
<b>Gjithsej llogaritë e arkëtueshme</b>	<b>132.39</b>	<b>0.00</b>

<b>Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro</b>
Paraja në bankë	260,731.64	244,297.99
Paraja në arkë	0.00	0.00
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>260,731.64</b>	<b>244,297.99</b>

<b>Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro</b>
Ratko Pavlovic BI	0.00	209.94
Slavolub Mandic BI	90.00	60.00
Gordana Radojković BI	180.00	0.00
Të tjerë	0.00	0.00
<b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>270.00</b>	<b>269.94</b>

<b>Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro</b>
Detyrimet për paga dhe tatime	15,06	1,587.95
Detyrimet për qira	30,28	322.03
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	0.00	0.00
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)	0.00	0.00
<b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>45,34</b>	<b>1,909.98</b>

**Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro**

Qëllimi i pagesës	Paguat ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Personi Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
Qiraja e Lokaleve afariste	Rados Petrovic	Anke Spajic 70 Mitrovice		04.01.2023	27,000.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			04.01.2023	500.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			03.02.2023	500.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Zhenski Kulturni Centar	Prote Stojana 24,Zveqan		08.02.2023	5,000.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Zhenski Kulturni Centar	Prote Stojana 24,Zveqan		09.02.2023	5,000.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Zhenski Kulturni Centar	Prote Stojana 24,Zveqan		10.02.2023	5,000.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			28.02.2023	500.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Zhenski Kulturni Centar	Prote Stojana 24,Zveqan		07.03.2023	5,000.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Zhenski Kulturni Centar	Prote Stojana 24,Zveqan		09.03.2023	5,000.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Zhenski Kulturni Centar	Prote Stojana 24,Zveqan		10.03.2023	5,000.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Zhenski Kulturni Centar	Prote Stojana 24,Zveqan		13.03.2023	5,000.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Zhenski Kulturni Centar	Prote Stojana 24,Zveqan		14.03.2023	5,000.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			04.04.2023	500.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Zhenski Kulturni Centar	Prote Stojana 24,Zveqan		12.04.2023	5,000.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			03.05.2023	500.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Zhenski Kulturni Centar	Prote Stojana 24,Zveqan		08.05.2023	5,000.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			01.06.2023	500.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			03.07.2023	500.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			04.08.2023	500.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Youth Health Creative Solution			09.08.2023	5,000.00

## SRPSKA LISTA

Shënime për Pasqyrat Financiare Vjetore 01 Janar 2023 deri me 31 Dhjetor 2023

Trajnim/Seminar/konferenca	Youth Health Creative Solution			10.08.2023	5,000.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Youth Health Creative Solution			11.08.2023	5,000.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			05.09.2023	500.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Youth Health Creative Solution			07.09.2023	5,000.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Youth Health Creative Solution			14.09.2023	5,000.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Youth Health Creative Solution			15.09.2023	5,000.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Youth Health Creative Solution			21.09.2023	5,000.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Youth Health Creative Solution			25.09.2023	5,000.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			02.10.2023	500.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Youth Health Creative Solution			19.10.2023	5,000.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			01.11.2023	500.00
Trajnim/Seminar/konferenca	Youth Health Creative Solution			22.11.2023	5,000.00
Qiraja e Lokaleve afariste	Stanoje Dimitrijeviq			30.11.2023	500.00
<b>Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro</b>					<b>133,000.00</b>